

U D H Ë Z I M
Nr. 2, datë 7.2.2002

**PËR HAPJEN E KUTIVE TË VOTIMIT DHE ADMINISTRIMIN
E DOKUMENTACIONIT TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 18 pika 1, 106 pika 8 dhe 149 pika 5 e 6 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N:

1. Me marrjen e kutive të votimit dhe fletëve të votimit të papërdorura dhe pas përfundimit të afatit për ankimet, sipas pikës 5 të nenit 113 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve hap të gjitha kutitë e votimit.

2. Për organizimin dhe kontrollin e punës për hapjen dhe selektimin e materialeve që do të ruhen dhe asgjësohen, ngrihet një komision i cili përbëhet nga:

- Sekretari i Komisionit Qendror	Kryetar
- Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore	Anëtar
- Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve	Anëtar
- Përgjegjësi i Zyrës së Protokoll – Arkivit	Anëtar

3. Hapja e kutive të votimit do të kryhet nga Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore, e cila në këtë proces do të aktivizojë specialistët e kësaj Drejtorie, si dhe një deri në dy inspektorë të Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore në varësi të volumit të punës, afatit të caktuar për përfundimin e procesit, si dhe të fondeve në dispozicion. Për plotësimin e kësaj detyre, Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore krijon disa grupe pune me këtë përbërje:

- një specialist,
- dy punëtor.

Hapja e kutive të votimit do të bëhet veças për çdo zonë zgjedhore.

4. Grupi i punës, me procesverbal, hap çdo kuti votimi, grupon veças dokumentet që do të arkivohen, materialet që mund të ripërdoren dhe pjesën tjetër që përbën materialet që do të asgjësohen. Ky procesverbal nënshkruhet çdo ditë edhe nga drejtori i Drejtorisë së Logjistikës Zgjedhore.

5. Dokumentacioni i cili do të dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit dhe do të ruhet për një afat kohor prej 5 vjetësh, është:

- procesverbalet e votimit,
- tabelat e rezultateve dhe procesverbalet e numrit të fletëve të votimit.

Sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, harton një grafik në lidhje me dorëzimin e materialeve që do të ruhen.

6. Materialet të cilat mund të përdoren edhe në zgjedhjet e tjera, magazinohen pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

7. Të gjitha materialet e tjera që gjenden në kutitë e votimit, të cilat nuk përfshihen në dokumentacionin e përmendur në pikat 5 e 6 të këtij vendimi, të ambalazhohen në thasë plasmasi dhe të bëhet asgjësimi i tyre nëpërmjet djegies.

8. Asgjësimi i dokumentacionit të panevojshëm, që gjendet në kutitë e votimit, do të bëhet me procesverbal, në prezencë të Komisionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi